

# Hylli i Dritës

*Ubi Spiritus Domini, ibi libertas.*

(II. ad Cor. III. 17).


1. Livriza e Shtetenvet	Fq. 217
2. Per Historin e Alfabetit Shqyp	„ 223
3. Marrveshtjet diplomatike ndermjet Napo- leonit të Madh e Ali Pashë Tepelenit	„ 231
4. Ali Bajraktari ( <i>Besa</i> )	„ 237
5. Nji ndër karakteristikat të shqyptarit	„ 247
6. Zblimet arheologjike në Fenik e në Butrint	„ 252
7. Matematika e Shqyptarit të malevet	„ 258
8. Nji dorshkrim i vjetës 1671 mî Shqypni	„ 265
9. Mirðita	„ 267
10. Stervitje logjike — Per f' i mrrijtë rrealitetit	„ 271
11. Quo vadis...? — 5.	„ 33

## POSTA E JONË

*Durrës. P. B.* Kê na shtojshi e renduem në numer të pajtimtarve, ndersa per kê ankoheshi e kemi shenjue q'at herë ndër pajtimtarë edhe numrat i a kemi dërgue rregullisht; në kje se nuk i ká rá në dorë ndo 'i numer na shkrueni e kemi me i a çue rishtas. U falemi nderës!

*Tiranë. M. F.* I kemi rendue në numer të pajtimtarve të rregullshem edhe ata të mramët, sikuerse paten bâ me mâ të parët, por nuk u a dërguem veç per me u a nisë të gjith së bashkut; sá per shka ankoheshi, kot pritni, mundni me na i dërgue edhe me manda-postë.

*Gjinokaster. Flet. « D-a »* Mas ankimit, qi bâshi u a dërguem numrat edhe të porositun, por as farë gjegjet nuk morem; lutemi na pergjegjni, posaçe per shka U a lypshim aq me ngut.





## Liuriza e Shtetenuet.

Trupi i nierit ásht i perbám prej shum gjymtyrësh, veprimi i të cillavet atý perpilohet të gjith, qi vetë ky trup t' ekzistojë, të zhvillohet e të forcohet; edhè dér sa kto gjymtyrë të veprojn rregullisht permbrenda rrethit t' aktivitetit të vet perkatës, ky trup ásht i shndoshtë, plot jetë e shndet e i kerthnestë.

Tash të mendojm se ktij trupi po i hín livriza: si bâhet, si shkon, si mbaron trupi i nierit? Dalëkadalë vjen e shkrihet, thahet, sa me mzì me u mbajtë m' kamë, dér qi s' mbrami des e shkatrrohet para kohet. Per ç' arsye? pse livriza, zânë vend nder organe ushqyse të trupit, ke perpîn vetë ushqimin e dhânun mbrendë, nuk lën m' u pertrî rregullisht në forcë të ré gjymtyrët, të cillat prandej shkatrohen, desin. Parasiti i neveritshem—livriza, ásht aj qi para kohet shkakton deken e ktij trupi.

Me ket trup ká nji analogí të madhe trupi morál, qi i thonë: familje. Sikúr në trup të gjallë gjymtyrët e ndryshme nuk veprojn në sý të ndonjájë interese të veçantë—sýni qi të shofë, veshi qi të ndiej, dora qi të perkasë, por shef sýni, ndien veshi, perket dora per kta qi trupi t' ekzistojë, të zhvillohet, të forcohet: kshtû edhè në familje gjymtyrët nuk veprojn per interese të veçanta, por per interesë të perbashkta të familjes: me fitue, me avitë gjân, per me mûjtë secilli me u edukue e me dalë i aftë per at qellim, per të cillin e din se ká pasë ekzistencen. Në familje nuk ká t' êmt a t'at—*meum, tuum*—por gjithshkafja ásht së bashku: aq e vertetë, qi atý—per posë se nder relacjone shpirtnore e fjeshtë civile—nuk sundon tjetër ligjë, posë ligjës së natyrës, e dashtunís.

